

**Zyra Logopedike LPB është përgjegjëse për këshillim dhe terapi tek fëmijët e vegjël nga moshja 2½ deri në fillimin e parashkollores, kur ato kanë vonesë të tepruar në zhvillimin e të folurit, çrregullime të hershme në përvetësimin(mësimin) e gjuhës(të folurit) dhe anomali(të meta) në të folurit.**

#### **Kur është logopedija tek një fëmijë i vogël e nevojshme ?**

- nëse fëmija në moshën 2½ akoma nuk flet shumë fjalë dhe nuk bënë lidhje të fjalëve
- nëse ju keni ndjenjë që fëmija nuk ju dëgjon mirë.
- nëse ju keni ndjenjë që fëmija nuk ju kupton mirë.
- nëse fëmija ka një bagazh të vogël të fjalëve
- nëse fëmija e ngatërron rradhitjen e fjalëve në fjali
- nëse fëmija belbëzon ose flet me nxitim
- nëse personat tjerë apo edhe ju vetë nuk e kuptoni fëmijun

#### **Çfarë përmban oferta jonë?**

##### **Konsultimi fillestar**

Prindërit mund të drejtohen drejt neve nëse kanë ndonjë pyetje rreth zhvillimit të të folurit të fëmijës së tyre. Në këtë konsultim konstatohet nëse është i nevojshëm marrja e mendimit nga një profesionalist.

##### **Terapia**

Duke ndërtuar besimin mes lidhjes tonë me fëmijën me anë të lojrave të përbashkëta i ngjallim atij interes dhe kënaqësi për të komunikuar dhe ashtu përmirësojmë mënyrën e tij të të mësuarit. Bazën e krijojnë veprimet shpontane të fëmijut gjatë lojrave, si dhe rrethanat e struktura e të përcaktuara nga terapistja. Mbështetjen e të folurit logopedja e bën nga njëra anë duke bërë ushtrime gjuhësore të cilat bazohen në parimet teorike për të mësuar gjuhën. Nga ana tjetër edhe veprimet shpontane të fëmijut modelohen sipas principit të njëjtë p.sh. duke i zgjeruar, ndryshuar dhe korigjuar veprimet e tij. Terapia e belbëzimit tek fëmijët, terapia mbi fonologjinë /shqiptimin e tingujve/ tingujt e vonuar apo të çrregulluar, terapia e të shprehurit me fjalë/dyspraksisë dhe terapia mbi problemet e ndëgjimit trajtohen me metoda më specifike. Terapia tek fëmijët e vegjël zhvillohet me intenzitet të ndryshëm.

##### **Këshillimi**

Këshillimi kryesisht u drejtohet prindërve. Në plan të parë qëndrojnë këto tema: mënyra dhe përmasa e çrregullimit të të folurit, rëndësia dhe fokusimi i terapisë, përmirësimi, mënyra se si të sillemi me të metën e fëmijës , mbështetja nga familja e fëmijës në zhvillimin e gjuhës gjatë të përditshmes, fillimi në kopshtin e lojrave respektivisht fillimin në parashkollore.

Sipas nevojës do të kërkohet bisedë e përbashkët me të gjithë personat që janë të përfshirë në zhvillimin e fëmijut( mjeku i fëmijut(pediatri), prindërit, terapistë të tjerë, udhëheqësja e kopshtit).

##### **Kush e merr pagesën përsipër?**

Për prindërit me vendbanim në kantonin e Cirikut,terapia logopedike është falas.